



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7233 Prot.

Roskovec, më 28.08 2025

VENDIM

NR 43 .DATË 28.08 .2025

***“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN KORRIK 2025”***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 16.07.2025, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Korrik 2025.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6149/1 Prot.

Roskovec, më 17.07.2025

Procesverbal Nr.7

-I mbajtur sot, datë 16.07.2025, ora 10⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Qershor 2025.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Qershor 2025.
5. Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë 2025-2027.
6. Për miratimin e Strategjisë Lokale për Zhvillimin e Turizmit në Bashkinë Roskovec 2025-2030.
7. Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.77 datë 23.12.2024 "Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025" të ndryshuar.
8. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
9. Për miratim fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
10. Për miratimin e tavaneve përfundimtare të PBA 2026-2028.
11. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 10⁰⁵

Këshilltarët prezent: A.Plaka, A.Lamaj, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, Zh.Metushi, E.Kaçeli, H.Hajdini, Dh.Malka, S.Bibo Qamili.

Këshilltarët që mungojnë: E.Buzi, N.Zeka, E.Xhaxhaj, J.Begaj, P.Toro, A.Hoxha, V.Çepele, A.Pelo, F.Feleq, E.Toska.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Ekonomik S.Çepele, Dr.Juridik V.Zeqo, Dr.Integritet European E.Shehu, P/Shërbimit Social S.Saliaj.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 11 këshilltar. Kryetari –ashtu sikundër jeni njoftuar në njoftimin dhe materialet e shpërndara tek ju në datë 11.07.2025, kemi rendin e ditës të njoftuar dhe nga ai rend dite i njoftuar nuk kemi asnjë

ndryshim. Duke vërejtur se në sallë kemi 11 këshilltar të pranishëm, do të thotë që kuorumi për zhvillimin e kësaj mbledhje është ai i domosdoshmi. Ju ftoj të gjithëve të nderuar këshilltar të votoni rendin e ditës për zhvillimin e kësaj mbledhje.

1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Qershor 2025.

Kryetari-ju ftoj të gjithëve të dëgjojmë një informacion të shkurtër nga Sekretarja e Këshillit në lidhje me vendimet e mbledhjes së muajit Qershor 2025. Sekretarja- ju informojë se në mbledhjen e kaluar ju keni miratuar gjithësej 6 vendime sipas informacionit që keni, dhe 3 prej këtyre vendimeve ishin vendime me karakter normativ, të cilat unë i kam nisur në Prefekturë për konfirmim ligjor. Duke parë se kjo mbledhje është bërë pak më shpejt se mbledhja që bëjmë gjithmonë, konfirmimi i Prefekturës në momentin që u shpërndanë materialet nuk kishte ardhur akoma, ka ardhur më vonë pasi materialet ishin shpërndarë. Nga konfirmimi i Prefekturës ju citoj se : Vendimi Nr.31 “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Roskovec” nuk është konfirmuar nga Prefektura për arsye se ky plan i mbetjeve donte një deklaratë mjedisore. Bashkia i ka bërë të gjitha procedurat për aplikimin në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të kësaj deklarate, por shkresa nga Ministria që na erdhi kërkonte dhe disa plotësime dokumentacioni. Janë plotësuar dokumentat dhe presim nga momenti në moment deklaratën mjedisore të miratuar nga Ministria. Në momentin që do vij deklarata, si procedurë ligjore ky vendim që nuk është miratuar nga Prefektura do anulohet në mbledhjen e radhës dhe pastaj do kalojë përsëri në momentin që do vij deklarata mjedisore për këtë vendim. Dy vendimet e tjera normative janë miratuar nga Prefektura. Të gjitha vendimet përveç vendimit i cili nuk është miratuar, u janë shpërndarë zyra për zbatime të mëtejshme. Elmazi-nëse ai vendim nuk ishte i kopsitur përse hyn në Këshill nga strukturat e Bashkisë? Kur atij i mungon baza ligjore dhe është e pamundur për të kaluar, atëherë pse vjen këtu në Këshill? Të na e kthejë Prefektura ne? Ne i kemi aparatet, kemi juristë, kemi tërë punonjësit e Bashkisë që janë të kopsitur për këtë punë. Maksi- sa i përket pyetjes së z.Elmaz, ka të bëjë me një projekt-vendim për të cilin ishin bërë të gjitha dokumentacionet ligjore pranë Ministrisë përkatëse dhe kishim marrë konfirmimin verbal nga Ministria që çdo gjë është në rregull. Deklarata është plotësuar me të gjithë dokumentacionin ligjor dhe na thanë që brenda datës së mbledhjes e keni deklaratën në Këshill. Nuk na erdhi kështu që do e shtyjmë për në mbledhjen tjetër. Ndjesë dhe në emër të administratës së Bashkisë e cila duhet të ishte më e përgjegjshme, dhe nga ana ime personalisht. Elmazi-i nderuar Nënkryetar nëse dokumentacioni nuk ishte në rregull dhe ty nuk të kishte ardhur nga Ministria, nuk kishe pse e fusje në mbledhjen e Këshillit, kur ai të ishte i kopsitur atëherë e fusje në mbledhjen e Këshillit dhe Këshilli e bën të fuqishëm për vendimmarrje. Kryetari-faleminderit z.Elmaz, në vazhdim të fjalës tuaj dhe unë do ti kërkoj administratës që të jetë më e vëmendëshme në të gjithë materialet të cilat i paraqet për miratim këtij Këshilli.

3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- besoj që të gjithë ju jeni njohur me këtë procesverbal, ka dikush ndonjë vërejtje në lidhje me procesverbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit? Nuk ka. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro.

4.Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Qershor 2025.

Elmazi- i nderuar Kryetar, nëse nuk ka shtesë ligjore, emrat të cilët ne i kemi para dhe i kemi kaluar dhe i kalojmë prapë, nuk kemi çfarë të dëgjojmë nga punonjësja e Bashkisë sa i përket ndihmave, prandaj unë mendoj ta kalojmë këtë pikë. Nëse ka ndonjë shtesë vendim qeverie po. Kryetari-e vlerësoj vërejtjen tuaj si me vend, gjithsesi punonjësja tregon gadishmërinë dhe përkushtimin e punës së bërë dhe prandaj është e pranishme në këtë sallë. Në qoftë se të nderuar këshilltar nuk kemi nevojë për të dëgjuar relacionin e saj, atëherë mund të vazhdojmë me procedurën. Dhurata-edhe unë ndaj të njëjtin mendim me kolegun, ne e kemi materialin këtu dhe nuk është e nevojshme që vajza ta sqarojë. Kryetari-fjalën dikush tjetër për pyetje apo diskutime në lidhje me këtë projekt-vendim e kërkon ndonjë nga këshilltarët? Nuk ka pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro.

5.Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë 2025-2027.

Dhurata-ne e patëm mundësinë që u mbledhëm me Kryetarët e grupeve, normalisht e studiuam çështjen ishim të gjithë prezent. Nga ana tjetër u mbledh dhe Komisioni, u zgjidhën problematikat..Në këtë moment vjen në sallë këshilltarja E.Toska, ora 10¹⁴. Prezent tani në sallë 12 këshilltar. Dhurata-megjithatë unë doja të shtoja vetëm diçka, duke u konsultuar edhe me zonjën që është përgjegjëse për atë punë, thashë nëse është e mundur të ketë sa më shumë gjithëpërfshirje, pavarisist se vajza na tha që është pak e pamundur se të rinjtë nuk janë shumë të motivuar, nuk janë shumë të prirur drejt këtyre aktiviteteve. Megjithatë nëse do ketë mundësi për zonat që janë shumë të larguara nga qendra e Roskovecit, të jetë një mjet për lëvizjen e të rinjve. Ia thashë edhe Enit dhe kjo e kishte të qartë, më tha po, me të parë në bazë të veprimtarive, mbase krijojnë një mundësi të tillë për të përfshirë dhe zonat, bëhet fjalë për Arapaj, Suk 1 e me radhë që janë më larg, kaq kisha faleminderit, dhe smendoj që ta lexojë vajza. Kryetari-unë në fakt gjej rastin të përgëzojë të dy Komisionet që u mbledhën këtë herë, duke e bërë funksionimin e këtij Këshilli në mënyrën më të mirë të mundëshme dhe në zbatim të rregullores dhe gjithçka që detyron ligji. Elizabeta Kaçeli Kryetare e Komisionit për Rininë- përshëndetje z.Kryetar, përshëndetje të nderuar kolegë anëtar të Këshillit Bashkiak Roskovec. Më datë 14.07.2025 u mbledh Komisioni për miratimin e planit lokal të veprimit për rininë 2025-2027 dhe kjo pikë mbeti për tu shqyrtuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, për shkak të disa pikave që ceki dhe kolegja. Megjithatë jemi shumë dakort që këto plane të vihen në zbatim, për një mbarëvajtje dhe zhvillim të rinisë në qytetin tonë, që të gëlojë ajo jeta rinore, në mënyrë që të sjellim risi që të rinjtë ti bëjmë ta duan këtë lloj eksperience dhe të gjejnë mënyra të ndryshme, faleminderit. Dr.Integriti Europian Enirjeta Shehu-është vetëm një ndryshim i vogël, është në prioritetin Nr.6 në të cilat kishim planifikuar 4 ndërhyrje, ndërkohë që kemi 3 ndërhyrje për arsye sepse ne Qendrën PAK e kemi aktualisht të

ndërtuar dhe e kryen funksionin e saj dhe nuk e kemi mundësinë për të krijuar një qendër PAK tjetër. Prioriteti 7 është aktualisht, bashkia e ka një laborator dixhital por ajo që mbetet për tu diskutuar është përfshirja e sa më shumë të rinjve. Ajo që ne kemi diskutuar dhe kemi pasur problematika dhe në momente të ndryshme, është realizimi i një marrëveshje bashkëpunimi me ZVA-në, shkollat sipas nevojave që ata kanë dhe sipas mundësive që ne si bashki kemi. Kryetari-këto ishin dy ndryshimet që ju keni paraqitur për këtë projekt-vendim? Enirjeta-po. Kryetari-do të lutesha që në rast të miratimit të projekt-vendimit me ndryshime, të paraqesni një kopje të ndryshimeve me shkrim pranë Sekretarisë në mënyrë që të pasqyrohet në vendimin përfundimtar. Leksi-nuk kisha ndonjë diçka për miratimin e këtij plani, është punuar shumë mirë, të bëhet vetëm pjesa e pjesmarrësve, rinia duhet të jetë më e përfshirë, është punë që duhet bërë me sesbën që këta të rinj të vijnë. Përderisa ka kaluar dhe në Komision unë jam pro këtij projekt-vendimi. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin me dy ndryshimet që paraqiti specialistja dhe miratohet unanimitet me 12 vota pro. Kryetari-me 12 vota pro pasi në orën 10¹⁴ në këtë sallë është shtuar dhe një këshilltare tjetër, e cila një rast të përsëritur i është bashkuar me vonesë mbledhjes së Këshillit. Miratohet ky projekt-vendim, do ti lutem edhe njëherë specialistes që dy ndryshimet ti pasqyrojë me shkrim dhe ti paraqesi pranë Sekretares së Këshillit.

6.Për miratimin e Strategjisë Lokale për Zhvillimin e Turizmit në Bashkinë Roskovec 2025-2030.

Kryetari-ka nevojë për relacion apo Komisioni e ka..Dhurata-jo, ndonjë diskutim. Kryetari-për pyetje ose diskutim kush e kërkon fjalën? Dhurata-sigurisht që materiali u lexua me shumë interes, unë pashë dhe disa tituj për miratimit e strategjisë lokale për zhvillimin e turizmit në Bashkinë Roskovec, keni përmendur disa burime turistike si :monumentet fetare, kënata, liqeni i Kurjanit, lumin Seman, keni përmendur edhe fushën e Myzeqesë si pjesë të përfshirë në peisazhin natyror, që ka dhe toka pjellore ku kultivohen me mijëra ton perime, sigurisht që ato eksportohen. Kultura bujqësore dhe blegtorale të cilat përfaqësojnë traditën prodhuese të komunitetit lokal. Keni përmendur gjithashtu që prodhimet e fermerëve kanë një rendiment të lartë, etj. Sa dhe si jeni në dijeni ju si grup pune për zhvillimin e turizmit, ju si drejtues të Bashkisë për të ardhurat që përfitojnë fermerët? Po për disfatat e tyre a jeni në dijeni? A keni qënë ndonjëherë pranë fermerëve për të ndarë hallet dhe shqetësimet që ata kanë? I jeni bashkangjitur ndonjëherë protestës së tyre? Ata kanë bërë me dhjetra por të paktën brenda Bashkisë tonë? Kishte jo pak para festës, që u organizua festa e Serave të Gjellbërta, për abuzimet që u ka ndodhur me shitjen e mallit a jeni në dijeni? Se ata të gjithë kanë qënë me problematika, se ju asnjëherë skeni qënë prezent. Keni organizuar festa, nuk ju bën përshtypje mosprezenca e të gjithë fermerëve? të gjithëve ju por edhe një pjese sikur një mase, ndërkohë atje kanë qënë të afërmit e punonjësve të Bashkisë që kanë marr pjesë në festën e Serave të Gjellbërta, ndërkohë në dijenin time sepse normalisht unë jam fermere jam shumë pranë, duke qënë dhe arsimtare jam shumë pranë prindërve të nxënësve, sigurisht të komunitetit duke qënë pjesë e atij se atje banoj, gjithandej ata ishin të shqetësuar. Tani ju bëtë atë festën, shumë bukur se dhe unë jam dakort me këto festa se në fund të fundit janë të bukura, askush si mohon dot por spati pjesmarrje për mendimin tim dhe të disa fermerëve të tjerë, sepse ata ishin shumë të shqetësuar, skaluan as dy javë u bë gjithë ajo protestë atje dhe askush nga Bashkia nuk erdhi, pse? Ndërkohë aktivitetet kulturore keni dëshirë ti bëni por pranë fermerëve nuk mundeni në asnjë moment? Këtë kam pyetje, faleminderit. Kryetari-atëherë, nuk arrijë ta gjej dot tërësisht lidhjen me projekt-vendimin që ne jemi duke diskutuar, gjithsesi për një përgjigje i jap fjalën

Nënkryetarit të Bashkisë z.Maksi. Maksi-znj.Dhurata faleminderit për pyetjen, unë do të përgjigjem rreth problematikës. A jeni të informuar thatë për të ardhurat që kanë fermerët? Kjo është një sipërmarrje private dhe kjo në bazë të Institutit të Statistikave nxirren të ardhurat që fitojnë nga 250 apo 300 hektar serash që ne kemi, nxirren dhe llogariten në normën për frymë të Bashkisë Roskovec, të cilat sa vijnë dhe rriten. Ndërsa përsa i përketë pastaj disfatave kuptohet që jo çdo vit është i suksesshëm në prodhimet e fermerëve, si puna juaj kemi edhe fermer të tjerë anëtar Këshilli, jo çdo vit janë të suksesshëm. Ne si Bashki të paktën kemi angazhuar dhe Ministrinë e Bujqësisë, Institutin e Studimit të Fidanëve kur patëm një disfatë të madhe me fidanin e domateve në mos gaboj para dy vjetësh, pra këtu është interesi dhe bashkëpunimi i Bashkisë, që është shumë i suksesshëm. Përsa i përketë pastaj problematikave të tjera që rritet çmimi apo jo, vet Zv.Kryeministrja ka qënë, ka marr sugjerimet, ka qënë në Roskovec ka marr dhe sugjerimet e fermerëve dhe të investitorëve..Dhurata-më fal, ku? Maksi-Zv.Kryeministrja ka qënë në Velmish dhe ka marr dhe sugjerimet..Dhurata-pse Velmishi është fshati më i madh i Bashkisë, që ka sipërfaqen më të madhe të serave? Maksi-ku e cakton ajo, ka caktuar në zonën fushore poshtë dhe i ka marr të gjitha, dhe nga fermerët edhe nga biznesmenët, dhe në Cërrik para tre ditësh Kryeministri i Shqipërisë me Ministrin e Bujqësisë pati një sesion të veçantë e gjithë qeveria për problematikat e bujqësisë, dhe këto janë të iniciuara edhe nga Kryetarja jonë e Bashkisë në takimin që pati me Kryeministrin pardje, të paktën ka ngritur problematikat e bujqësisë. Dhurata-unë e ndoqa por asnjëra nga ato nuk kishte të bënte me shitjen e prodhimeve. Maksi-problematikat që ngriti Kryetarja kishin të bënin me legalizimin e tokave një, me kanalet dy, me rrugët bujqësore tre. Këto janë problematika që ne i kemi ngritur vazhdimisht dhe i ngrejmë. Është një sipërmarrje e Kryeministrit dhe e Ministrisë apo Zv.Kryeministres që bujqësia meqënëse Bashkia e Roskovecit është Bashki bujqësore, të ketë një administratë më të zgjeruar sa i përketë organikës që do merret me bujqësinë, agronom e të tjera me radhë, është inisiativë e Ministrisë dhe e Kryeministrit dhe do zbatohet sipas porosive që do të japi, pra do të jemi më pranë fermerëve dhe problematikave që ngritët. Dhurata-unë mendoj a nuk ka mundësi brenda Bashkisë të ngrihet një grup pune posaçërisht për fermerët, për shitjen e prodhimeve të tyre sepse janë dy sezone në vit që ato janë madhore,ja tani fillon, ai është në vazhdimësi, prodhimet për momentin tani janë shumë të pakta serat të cilat kanë prodhime, por shumë shpejt do të dalin për 3 javë. Gjithmonë fermerët rrinë në ankth dhe rrinë në frikë, asnjëherë nuk absolutisht nga Bashkia, pse ska një grup? Tani për momentin filloi edhe bostani, janë mbjellë me qindra hektarë bostan në zonën poshtë dhe tani ai ka një çmim që është nën kosto, nuk mundet të ngrini një grup pune sikurse bëni veprimtaritë kulturore-artistike? Maksi-grupet e punës janë të ngritura, janë shqetësime të fermerëve që janë çuar deri në tryezën e Kryeministrit të Shqipërisë..Dhurata-po se asnjëherë nuk janë bërë në dijeni, të paktën ta dijë populli. Më fal Maksi tani spo them se gjërat që duken ska nevojë ti përmendim, sigurisht që diku mungon edhe uji por ne u rregulluam, pavarësisht që ai ujë nuk është as i pijshëm as i pastër shumë por gjithsesi po themi që kemi ujë, ndërkohë kemi dëgjuar zona të tjera që skanë, të themi të vërtetën. Por ama themi edhe për rrugët, mirë apo keq u bënë jo sipas standarteve sepse Kryetarja tha si kemi marr akoma përsipër por jam e sigurt që i keni marr, po prapë po themi që janë bërë sepse nuk i mohojmë dot por ama duhet bërë për fermerët sepse ka të bëjë me jetën e fermerëve, me djersën e tyre dhe është shumë për të ardhur keq, çdo sezon e njëjta situatë. Maksi-unë nuk e di e ke dëgjuar fjalën e Kryeministrit në takimin që pati në Cërrik me gjithë Kryetarët e Bashkive dhe fermerët? Dhurata-unë dua konkretisht çfarë bën Kryetarja e Bashkisë tonë? Maksi-Kryetarja e Bashkisë e ke dhe në rrjetet sociale, ka qënë e vetmja që ka ngritur tre probleme me

Kryeministrin e Shqipërisë dhe i ka thënë një, dy, tre dhe tre probleme nuk është se smori përgjigje, mori përgjigje por zgjidhja ka kohën e vet për tu dhënë. Leksi-shqetësimi i Dhuratës dakort që është në rregull gjithçka por qëndrojmë tek pika e rendit të ditës dhe vazhdojmë më mbrapa, se edhe unë kam probleme për më mbrapa. Kryetari-është një shqetësim dhe brenda Drejtorisë së Bujqësisë le të shqyrtohet edhe ky shqetësim, nuk ka asnjë gjë. Leksi-shqetësuese është nuk diskutohet. Elmazi-i nderuar Kryetar në shqetësimet që ne ngrejmë, ne duhet të shikojmë ku janë dobësitë nëpërmjet atij materjali dhe duhet ti trajtojmë. Problemi i parë qëndron sepse fermerët kush ka ndërtuar, cili sektor ka më shumë sera, aktivitet, atje bëhet dhe aktiviteti, pa ofenduar njërin fshat apo tjetrin. Nuk ka pse vihet në Velmish me 10 hektar sera kur Suku 1, Suku 2 dhe Arapaj ka 400 hektar sera, duhet të ketë një llogjikë nga ana e atyre që drejtojnë, në gjykimin tim. Dhurata-më fal për ndërhyrjen sepse festa atje u bë në Suk ç'është e vërteta, por sa ishte pjesëmarrja e fermerëve? Kryetari-po nuk ka forcë Këshilli që të vendosi axhendën e Zv.Kryeministres. Elmazi-sa i përketë çmimeve të tregut, nuk i vendos Bashkia, kush nuk ka parë le të dali të shikojë, kush nuk ka dal ti jepet mundësia të shikojë, çmimet e tregut i vendos vet privati, i vendos tregu i përgjithshëm, është tregu nuk jemi ne. Të ngrejë jo grup pune Majlinda..Dhurata-më fal po cili është tregu? Ja tek e ke tregun aty, ja tregu tjetër mbrapa, fol me ata të dy. Elmazi-të lutem..Kryetari-ju lutem z.Elmaz, mos të dalim nga rendi i ditës dhe mos të bëjmë replika personale, ju lutem të përqëndrohemi. Gjërat personale..(në sallë ka diskutime midis Dhuratës dhe Rrapit) Kryetari-znj.Dhurata ju lutem gjërat personale mos i diskutoni këtu se nuk janë as në nderin tuaj dhe as në nderin e kësaj mbledhje. Diskutimi vazhdon. Kryetari-znj.Dhurata të lutem, të tërheq vëmendjen, nuk është as në nderin e Këshillit as tëndin personal për të diskutuar këtu në këtë mbledhje gjërat personale, keni kohë plotë për ta diskutuar. Në lidhje me projekt-vendimin z.Elmaz ? Elmazi-a mund ta vazhdojë unë apo ta lë? Kryetari-po, ju mund ta vazhdoni vetëm në rast se i përmbaheni projekt-vendimit të cilin ne po diskutojmë. Elmazi-po, gjithmonë projekt-vendimit. Nëse bëhet dëgjese publike apo takime me fermerët, mos të ketë dallime të majtë apo të djathtë, duhet të jenë të gjithë të ftuar, e drejta e tyre marrin apo smarrin pjesë. E fundit është, mos ta kërkojmë neve këtu në Këshill, gjykimi im mund ta kem gabim, nga pikat e grumbullimit ato që ndjekin tregun e çmimet dhe që vendosin, nuk jemi ne në Këshill, faleminderit. Kryetari-faleminderit z.Elmaz. Dikush tjetër e kërkon fjalën për diskutim apo pyetje në lidhje me projekt-vendimin? Nuk ka më pyetje dhe diskutime nga këshilltarët. Kryetari- kishit gjë për të shtuar për këtë projekt-vendim? Enirjeta-po, atë që doja të shtoja është se gjatë diskutimeve që kemi bërë dhe materialeve që kemi marr nëpërmjet imeilit dhe prej diskutimeve fizike në dëgjese publike, janë vendosur dhe dy zona të cilat janë me potencial turistik, është zona e Marinzës dhe Rezervuari i Ngjeqarit, janë dy nga zonat të cilat janë me potencial turistik për tu zhvilluar. Maksi-pse se ke futur se kjo është diskutuar, pse nuk është futur në material? Enirjeta-në këtë pikë. Kryetari-kërkoj vëmendjen tuaj të nderuar këshilltar sepse specialistja thotë që në projekt-vendimin që jemi duke diskutuar ka bërë dhe dy shtesa të cilat a mund ti përmendni prapë këto shtesa? dhe ashtu siç ju thashë për projekt-vendimin paraprak, do ju lutem që në përfundim të diskutimit tuaj të gjeni mundësinë dhe ti paraqesni dhe me shkrim pranë Sekretarisë këto dy ndryshime, në mënyrë që të përfshihen saktë në vendimin përfundimtar. Enirjeta-tju lexojë gjithë relacionin? Këshilltarët-ske pse i lexon. Leksi-ndryshimet i morëm vesh. Kryetari-atëherë të nderuar këshilltar ju propozojë të votoni projekt-vendimin “Për miratimin e Strategjisë Lokale për Zhvillimin e Turizmit në Bashkinë Roskovec 2025-2030” me ndryshimet e paraqitura, ndryshime të cilat kanë ardhur si nevojë, marr shkas nga takimet që janë bërë në dëgjese publike dhe nga

materialet e dërguara në adresën e imeilit përcaktuar për këtë qëllim. Hidhet në votim projekt-vendimi me ndryshimet si më sipër dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro. Kryetari-me 12 vota pro miratohet ky projekt-vendim me dy ndryshimet e sipërpërmendura.

7.Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.77 datë 23.12.2024 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025” të ndryshuar.

Kryetari-për të parë këtë projekt-vendim është mbledhur dhe Komisioni përkatës, nuk e di nëse Komisioni përkatës ka dal me një relacion? Floriana Kryetare e Komisionit të Ekonomisë-përsëritet të gjithëve, që mos ta lexojë kot raportin, ne u mbledhëm si Komision, diskutuam dhe nuk kishim ndonjë problematikë, kështu që jemi dakort, faleminderit. Kryetari-ka nevojë për këtë, e kemi diskutuar dhe në mbledhjen e kaluar këtë projekt-vendim. Elmazi-dhe unë jam dakort sepse u mbledhëm si grup, si Komision, i shikuam të gjitha materialet për të cilat ramë dakort, nuk kishte ndonjë vërejtje prandaj mendojmë ta kalojmë. Kryetari-e kërkon dikush fjalën për pyetje apo diskutime në lidhje me këtë projekt-vendim? Nuk ka. Kryetari-atëherë për sa kohë çdo gjë është e qartë dhe nuk kemi pyetje dhe diskutime, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.77 datë 23.12.2024 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025” të ndryshuar”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 11 vota pro, 1 votë abstenim Dh.Malka. Miratohet.

8.Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.

Leksi-është pikë e rendit të ditës së kaluar. Kryetari-cila ishte? Leksi-kjo pra shpërndarja e fondeve, e kishim pikë të rendit të ditës, u diskutua dhe në Komision. Kryetari-atëherë Leksi në qoftë se do ta drejtosh ti mbledhjen ? Të lutem të mbarojë prezantimin e projekt-vendimit, do kërkoj fjalën dhe do shprehësh gjithçka që mendon se është e arsyeshme për tu shprehur në këtë mbledhje. Të nderuar këshilltar jemi në pikën 8 të rendit të ditës “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025”, do ju lutem është një pikë të cilën ne e kemi diskutuar dhe në mbledhjen e kaluar të këtij Këshilli dhe besoj që nuk ka nevojë që të dëgjojmë relacionin edhe njëherë nga fillimi, apo ka nevojë? Ka nevojë dikush ta dëgjojë si relacion në këtë mbledhje? Këshilltarët-jo ska nevojë. Kryetari-për pyetje, për diskutim e kërkon dikush fjalën? Dhurata-unë jam dakort me materialin sepse e lexova sigurisht, aty ku thotë shërbime bujqësore, tek shërbimet bujqësore a ka mundësi që të shtohet, se nuk e di sesa jeni ju në dijeni të paktën, sepse une lëviz pak si shumë, jo në shkollë, jo kur shkoj tek pronat e mia andej nga serat dhe normalisht nuk mund të shtoni dhe diçka, një makinë korrëse bari apo diçka elementare për atë kanal kryesor që po funizon gjithë Bashkinë e Roskovecit, se atje po merr dhe ujë liqeni i Kurjanit apo jo? dhe ai është mbushur vetëm ferra, madje ferrat kanë zënë dhe rrugën dhe një makinë spo kalon dot, kalonin dy tani dhe njëra spo kalon dot. Shtoni një korrëse bari aty se fundja nuk është keq, shtoni edhe këtë kështu që unë jam dakort me materialet. Maksi-në investimet e vitit 2026 ne kemi planifikuar dhe një korrëse bari, jemi plotësisht dakort. Kryetari-faleminderit znj.Dhurata. Tjetër kush e kërkon fjalën për pyetje, për diskutim në lidhje me projekt-vendimin? Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari-për sa kohë pyetje dhe diskutime nuk kemi,

ju ftojë të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimit me 12 vota pro.

9.Për miratim fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.

Selmani-baza ligjore është po ajo për të gjitha ndryshimet që bëhen në buxhet dhe kjo është paraqitur me kërkesë dhe relacion dërguar nga stafi i projektit me financim të huaj “Rivitalizimi i Qendrës Komunitare Kurjan” si dhe i marrëveshjes së grandit që është lidhur me Komisionin Europian, dhe kërkohet fond prej 4 milion 112 mijë e 722 lekë ose 42 mijë e 18 euro, e ndarë si më poshtë sipas zërave. Ky është një fond që në bazë të kontratës të lidhur që në fillim, do të rikthehet me përfundimin e këtij projekti dhe që do bëhet ajo përfundimtare, plan faktet të realizimit përfundimtar dhe do ti kthehet përsëri Bashkisë, po aktualisht tani kërkohet financim që ta bëjmë ne, dhe ky fond është marr nga zëri që ne kemi planifikuar që në fillim të vitit, në buxhetin e vitit 2025, në zërin “Kontribute për investimet me donator të huaj”. Kryetari-ndonjë nga këshilltarët kërkon fjalën për pyetje në lidhje me këtë projekt-vendim? Për diskutime? Nuk ka pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimit me 12 vota pro.

10.Për miratimin e tavaneve përfundimtare të PBA 2026-2028.

Selmani-të gjitha këto shifra kanë të bëjnë dhe me dokumentin që ju miratuat mbledhjen e kaluar, për miratimin e fazës së parë të PBA-së. Këto tavane që neve ju kemi paraqitur është për fazën e dytë, e cila do të përfundojë në Shtator dhe pastaj për fazën përfundimtare që përfundon në muajin Dhjetor. Patjetër që duhet kjo vendimmarrje me qëllim që të vazhdojë puna në vazhdim. Kryetari-pak vëmendje dhe qetësi ju lutem. Në lidhje me këtë projekt-vendim kërkon njeri fjalën për pyetje dhe diskutim? Nuk ka pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 11 vota pro, 1 votë kundër Dh.Malka. Miratohet.

11.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari-qytetarë të pranishëm dhe të regjistruar për diskutime nuk kemi. Nga ana e këshilltarëve ka dikush diçka për të diskutuar, duke pasur parasysh faktin që këtu kemi dhe Nënkryetarin e Bashkisë? Elmazi-më vjen keq që më mirë mos të shkruaj fare këtu në fund diskutime nga publiku, për të vetmen arsye se çfarë ngrihet asgjë nuk bëhet, do të thotë bieri legenit ti se po të dëgjojë unë, dhe më vjen keq që e shpreh në këtë mënyrë, por e meritojnë ta them këtë gjë, pse? Ore keni perëndi a ça keni, ore i keni parë rrugët që neve ikim, udhëtojmë, nga shtëpia e Halit Vrapit dhe shkojmë tek ura e Jagodinës ? E keni prishur xhaden o Maksi, u kemi thënë hidhi çik rërë apo zhavorr, hodhët një pjesë aty dhe pjesa tjetër është të vësh duart në kokë, do tank të ikësh, më vjen keq. Ore ne të themi për rrugët e parcelave që i nderuar Kryeministër po thotë zbrisni dhe shikoni, dhe e ngriti Kryetarja e Bashkisë për rrugët e blloqeve që nuk është lënë, është e vërtetë që nuk është lënë, por është e vërteta e madhe që ne si fermer e kemi lënë rrugën dhe flas tek 8/8, është lënë rruga nga xhadja e deri në fund tek argjinatura dhe nuk është bërë asnjë gjë, nuk ikën dot. Maksi-e ke për rrugën e Jagodinës apo rruga Roskovec-Strum? Elmazi-unë fola për rrugën nga

Roskoveci tek ura e Jagodinës, ura e parë, ura e dytë. Maksi-është rruga e Autoritetit Kombëtar të Rrugëve deri tek ura. Elmazi- ça po thua o Maksi? Maksi-ti po thua për rrugën kryesore apo jo? Leksi-jo spo thotë për rrugën kryesore, e ka thënë tek rruga e Koli Kolës, ajo është rrugë e brendëshme. Elmazi-e dyta, ty po të flas prapë o Nënkrjetar, ore ushqehemi nëpërmjetë tokës ne, përveç dikujt që ka të ardhura të tjera në bazë të profesionit që kanë dhe skam të drejtë të ofendojë askënd nga anëtarët e Këshillit, po ne që nuk kemi të ardhura dhe vemë punojmë tek ajo tokë, nuk vemë dot, kudo që shkel ti thonë ata ore do na hidhni ndonjë dorë dhe këtu, dhe më e keqja është që ne e ngrejmë në çdo mbledhje një gjë të tillë. Dhurata-meqë kolegu parafoles u ndal tek rrugët, atje do të ndalesha edhe unë. Tani unë të jem e sinqertë përgëzime për ato rrugë që janë bërë sepse ne i kemi rrugët tek parcela. Më vjen keq koleq që ju skeni por do ti bëni shumë shpejt edhe ju mos u shqetësoni. Megjithatë do thoja për rrugën kryesore nga Jagodina deri poshtë tek shkolla në Suk 2, janë bërë disa gropa dhe janë vërtetë problematike dhe janë zgjeruar shumë, janë bërë shumë të mëdha. Po keni mundësi këto gjëra ti shikoni pak, të paktën them faleminderit për ato që janë bërë. Leksi-një pyetje, Arlinda kanë ardhur ato që kanë ngritur shqetësimet? Sekretarja e Këshillit-mbledhja u bë pak shpejt dhe akoma nuk kanë ardhur. Kryetari- atëherë në qoftë se nuk kanë ardhur është i lutur z.Maksi që të ketë në vëmendje kthimin e përgjigjeve për të gjitha kërkesat që kanë bërë këshilltarët. Nuk ka më diskutime. Maksi-meqënëse jemi në fillimin apo mesin e pushimeve verore dhe u kërkuam ta bënim këtë mbledhje jashtë radhe, do tju uroj të gjithëve, faleminderit dhe pushime të mbara. Kryetari-duke ju falenderuar për pjesëmarrjen në këtë mbledhje të nderuar këshilltar, njëkohësisht e dini që jemi në prag të festës së Roskovecit, në fund të kësaj mbledhje jeni të lutur që të merrni ftesat e personalizuar për secilin nga ju. Ftojë dhe të gjithë qytetarët që të jenë pjesëmarrës në këtë festë të qytetit tonë. E deklarojë këtë mbledhje të Këshillit të Bashkisë të mbyllur, faleminderit edhe njëherë për pjesëmarrjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

